


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	06.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-04/14
PËR/ZA/TO:	z. Bajram Dërmaku, Kryesues i Kuvendit në Komunën e Dardanës (Kamenicës)
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Dërmaku,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i Funksioneve publike si Kryesues i Kuvendit në Komunën e Kamenicës dhe Koordinator në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Kamenicë, shprehimisht nuk është i ndaluar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit, me kërkesën e z. Bajram Dërmaku ka filluar procedurën për trajtimin e rastit me nr. protokolli AKK-03-170/14, i cili ushtron funksionet publike si Kryesues i Kuvendit në Komunën e Dardanës dhe si Koordinator në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Kamenicë.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit, në bazë të kompetencave të parapara me ligj, bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave, neni (19 paragrafi 5) i Ligjit Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik, e që përfshihen edhe Kryesuesit e Kuvendit Komunal, kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Rjedhimisht, neni 16 i këtij ligji, përcakton kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik. Në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë dedikohet për shkak të funksionit.

Prandaj, pyetja juaj për mundësinë e ushtrimit të funksionit të dytë, si Koordinator në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Kamenicë krahas funksionit tuaj publik, si Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, shprehimisht nuk është i ndaluar.

Andaj, iu këshillojmë që të respektoni Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në të cilin, ndër të tjera, përcaktohen detyrimet e nëpunësve civilë. Në bazë të nenit 5 (paragrafi 8) të këtij ligji nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit.

Ndërsa, neni 17 (paragrafi 1) të këtij ligji, shprehimisht thotë:

Nëpunësit civilë mund të mbajnë, përkohësisht, pozita politike. Gjatë mandatit të tyre në këto pozita, statusi i tyre i nëpunësit civil pezullohet për shkak të mospërputhshmërisë ndërmjet emërimit politik dhe statusit të nëpunësit civil.

Prandaj, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinioni për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë zyrtarin e lartë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt!